



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2021:039632

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05630477

Kom.Dh.Shk.II.nr.64/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Ashensor Gold”, Sh.P.K., me seli në Ferizaj, me numër të regjistrimit të biznesit 811047209, që sipas autorizimit përfaqësohet nga J.O., avokat nga Prishtina, kundër debitorit Kosova Home, Sh.P.K. me seli në Prishtinë, rr.”Xhavit Mitrovica”, obj 2/2, e përfaqëson me autorizim H.Sh. avokat, për shkak të borxhit sipas dokumentit të besueshëm - faturave, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1059/22, të datës 13.09.2023, me datën 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Ashensor Gold”, Sh.P.K., me seli në Ferizaj, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1059/22, të datës 13.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykat1 Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1059/22, të datës 13.09.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimi i debitorit Kosova Home, Sh.P.K. me seli në Prishtinë, të ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.12/21, i datës 11.01.2021, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Afet Mjeku nga Prishtina, ashtu që e ka shfuqizuar Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.12/21, i datës 11.01.2021, duke i abroguar të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje përmbarimore.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit në tersi si e bazuar dhe të aktvendimi i atakuar të prishet dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Debitori ka parashtruar përgjigje në ankesë, me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa e kreditorit dhe aktvendimi i atakuar të vërtetohet.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Kreditori “Ashensor Gold”, Sh.P.K., me seli në Ferizaj, me datë 11.01.2021, ka ushtruar propozim për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës me Nr. 11/19, të datës 11.06.2019, për shumën prej 13,500.00€.

Përmbartuesi Privat Afet Mjeku nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me datë 11.02.2021, ka nxjerrë Urdhrin Përmbartimor P.nr.12/21, me të cilin ka caktuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit, në bazë të faturës së lartpërmendur, që konsiderohet dokument përmbartimor në bazë të nenit 29 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore (LPP).

Kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit, debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar Urdhrin në fjalë si të padrejtë dhe të pabazuar, ngase mungon pranimit i faturës nga ana e debitori, pra është faturë e njëanshme dhe e pa përshtatshme për përmbartim, andaj propozojmë që të aprovohet prapësimi dhe urdhëri përmbartimor të shfuqizohet dhe të obligohet të gjitha shpenzimet e procedurës ti bartë kreditori.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka kundërshtuar pretendime e debitorit në prapësim dhe ka propozuar që të refuzohet prapësimi si i pa bazuar dhe urdhëri përmbartimor të mbetet në fuqi dhe të detyrohet debitori ti bartë shpenzimet e procedurës përmbartimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së parë me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1059/22, të datës 13.09.2023 e ka aprovuar si të bazuar prapësimi i debitorit Kosova Home, Sh.P.K. me seli në Prishtinë, të ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.12/21, i datës 11.01.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku nga Prishtina, ashtu që e ka shfuqizuar urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.12/21, i datës 11.01.2021, duke i abroguar të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje përmbartimore, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parapara me nenin 182 par.2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK.

Sa i përket pretendimeve për zbatimin e gabuar të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka përfunduar urdhrin për përmbartim. Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se dokumenti i besueshëm-fatura, në bazë të cilit organi përmbartues ka caktuar përmbartimin, nuk i plotëson tiparet e përmbartueshmërisë.

Me Nenin 29 par.3 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP) është paraparë që për përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm “*është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.*” Ndërsa me nenin 29 par.1 të LPP-së është përcaktuar se “*Përmbartimi me qellim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”.

Ndërsa me Nenin 37 të LPP-së parashihet se “*Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”. Po ashtu me nenin 29 par.1 nën paragrafi 1,3 të LPP-së është fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Prandaj, në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se fatura në bazë të se cilës është lejuar propozimi për përmbartimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se fatura është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, po ashtu nuk përmban nënshkrimin e debitorit.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin me arsyet se urdhri për përmbartim është lejuar mbi bazën e faturës të cilat jo vetëm se nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, por fatura nuk përmban as elementet për t’u cilësuar si faturë e rregullt apo dokument i besueshëm ngase mungon pranimit i rregullt dhe i nënshkruar nga e debitorit. Kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur edhe kur ka vlerësuar se nga flete kthesa postare e cila gjendet në shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet si dorëzim i rregullt, pasi që nga flete kthesa vërtetohet nënshkrimi i marrësit i dorëzuesit i datës 29.09.2020, mirëpo të lloji i dërgesës nuk ka shënim se cilat dokumente janë dorëzuar, andaj nga kjo nuk mund të vërtetohet se ky dorëzim është i rregullt në mungesë të shënimeve të lloji i dërgesës.

Kjo Gjykatë vlerëson se fakti se debitori, në rastin konkret faturën kontestuese, si dokumente nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, pasi që është lëshuar në mënyrë të një anëshme, dhe nuk përmban nënshkrimin e pranuesit-debitori. Që fatura të konsiderohet si pranimit i rregullt, do të duhej që debitori si palë kontraktuese, apo përfitues i shërbimeve ta pranonte faturën e rregullt me vënien e nënshkrimit nga personi përgjegjës apo i autorizuar. Së këndejmi, Gjykata gjen se urdhri për përmbartim i caktuar nga përmbartuesi privat është lëshuar në bazë të një propozimi për përmbartim i cili nuk i ka plotësuar kushtet që kërkohen me Nenin 39 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.64/24, me datë 29.04.2024

Gjyqtari
Dren Rogova